

URDHËR
Nr. 174, datë 28.7.2023

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të pikës 1 të nenit 12, të germës “b” të nenit 13, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si edhe të germës “c”, pika 2, të nenit 7, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e pjesshëm të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, gjyqtarës më të vjetër në moshë, znj. Mimoza Tasi, si në vijim:
 - Përfaqëson Kolegjin në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë, por jo kufizuar këto marrëdhënie me institucionet e tjera, organet publike, organizata ndërkombëtare.
2. Delegimin e kompetencës së mësipërme për periudhën 4.8.2023–11.8.2023.
3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtarja më e vjetër në moshë znj. Mimoza Tasi.
4. Znj. Mimoza Tasi nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo